



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Drejtoria e Bujqësisë

THIRRJE PËR APLIKIM

1. Përkrahje në blegtori – makina mjelëse

Ftohen të gjithë fermerët e komunës së Prishtinës, të cilët posedojnë gjedhe qumështore, dele dhe dhi, se mund të aplikojnë për furnizim me makina mjelëse dhe bidonë.

Kriteret e përgjithshme:

- Të kenë 3 deri 14 krerë gjedhe qumështore;
- Të kenë nga 30-150 krerë dele qumështore;
- Të kenë nga 20-150 krerë dhi qumështore;
- Kafshët duhet të jenë të matrikuara;
- Përfituesi duhet të jetë banor rezident i komunës së Prishtinës, si dhe objekti (stalla) për vendosjen e gjedheve, deleve apo dhive të jetë në territorin e Komunës së Prishtinës;
- Nuk kanë të drejt përfitimi fermerët dhe anëtarët e ngushtë në bashkësi familjare të cilët kanë përfituar në 3 (tri) vitet e fundit makina mjelëse nga Komuna dhe donatorët në bashkëpunim me Komunën;
- Nuk mund të jetë përfitues më shumë se një anëtar i bashkësisë familjare;
- Fermerët të cilët nuk e kanë pronën në pronësi familjare, por shfrytëzojnë toka më qira, duhet të kenë marrëveshjen kontraktuese të nënshkruar nga të dy palët.

Kriteret specifike:

- Fermerët që kanë numër më të madh të krerëve të gjedheve, deleve dhe dhive qumështore, kanë përparësi në raport me ata që kanë numër më të vogël;
- Në kushte të barabarta, përparësi kanë zonat me prioritet të identifikuar nga komuna;
- Njohuritë elementare në fushën përkatëse;
- Fermerët me përgatitje profesionale shkollore (shkolla e mesme bujqësore, fakulteti përkatës);
- Fermerët të cilët kanë ndjekur trajnime përkatëse;
- Gratë fermere dhe grupet e marginalizuara;
- Familja (fermerët) pa asnjë anëtarë të punësuar;
- Madhësia e fermës (numri i gjedheve, deleve, dhive qumështore);
- Prona në pronësi të aplikuesit (fermerit);
- Infrastruktura përcjellëse (sistemi i bartjes së qumështit);
- Largësia e fermës nga vendbanimi.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Numri identifikues i fermerit (NIF);
- Kopja e një dokumenti identifikues të Republikës së Kosovës;
- Vërtetimi nga shërbimet veterinarë të licencuara nga organet përkatëse;
- Vërtetimi mbi tatimin në pronë për vitin 2020;
- Marrëveshja në mes palëve.

VËREJTJE


Nëse komisioni parasheh të nevojshme sjelljen e dokumenteve shtesë të cilat mundësojnë zgjedhjen e përfituesit, qytetari (fermeri) është i obliguar që t'i sjellë ato në afatin i cili i caktohet, në të kundërtën humb të drejtën për të qenë përfituesi i subvencionit (grantit).

Data e aplikimit, prej 26.04.2021 deri më 30.04.2021



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina**



Drejtoria e Bujqësisë

THIRRJE PËR APLIKIM

2. Përkrahje në blegtori – Laktofrizë,

Ftohen të gjithë fermerët e komunës së Prishtinës, të cilët posedojnë gjedhe qumështore, se mund të aplikojnë për furnizim me laktofrizë.

2.1 Furnizimi me laktofrizë 500L

Kriteret e përgjithshme:

- Të jetë banor rezident i komunës së Prishtinës dhe objekti (stalla) për vendosjen e gjedheve të jetë në territorin e komunës;
- Të kenë 10 krerë e më shumë gjedhe qumështore;
- Gjedhet qumështore duhet të jenë të matrikuara;
- Nuk kanë të drejt përfitimi fermerët dhe anëtarët e ngushtë në bashkësi familjare, të cilët kanë përfituar në 3 (tri) vitet e fundit pajisje për ruajtjen e qumështit - laktofriz nga Komuna dhe donatorët në bashkëpunim me Komunën;
- Nuk mund të jetë përfitues më shumë se një anëtar i bashkësisë familjare;
- Fermerët të cilët nuk kanë pronën në pronësi familjare, por shfrytëzojnë toka me qira, duhet të kenë marrëveshjen kontraktuese të nënshkruar nga të dy palët.

Kriteret specifike:

- Fermerët që kanë numër më të madh të krerëve të gjedheve qumështore, kanë përparësi në raport me ata që kanë numër më të vogël të gjedheve qumështore;
- Në kushte të barabarta, përparësi kanë zonat me prioritet të identifikuara nga komuna;
- Njohuri elementare në fushën përkatëse;
- Fermerët me përgatitje profesionale shkollore (shkolla e mesme bujqësore, fakulteti përkatës);
- Fermerët të cilët kanë ndjekur trajnime përkatëse;
- Gratë fermere dhe grupet e marginalizuara;
- Familja (fermerët) pa asnjë anëtar të punësuar;
- Madhësia e fermës;
- Prona në pronësi të aplikuesit (fermerit);
- Infrastruktura përcjellëse (vendin e rregulluar për vendosjen e laktofrizit) sipas standardeve;
- Përfituesi i pajisjes Laktofriz nuk mund të jetë edhe përfitues i pajisjes Mikser ose anasjelltas;
- Largësia e fermës nga vendbanimi;
- Fermerët të cilët kanë marrëdhënie kontraktuale për shitjen e qumështit me qumështoret në tri (3) vitet e fundit;

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Numri identifikues i fermerit (NIF);
- Kopja e një dokumenti identifikues valid të Republikës së Kosovës;
- Vërtetimi nga shërbimet veterinarë të licencuara nga organet përkatëse;
- Kontratë, marrëveshje me pikën grumbulluese të qumështit (qumështoren);
- Pasqyra financiare për pagesën e qumështit nga ana e qumështores në 3 muajt e fundit;
- Vërtetimi mbi tatimin në pronë për vitin 2020;
- Marrëveshja në mes palëve;
-

VËREJTJE

Nëse komisioni parasheh të nevojshme sjelljen e dokumenteve shtesë, të cilat mundësojnë zgjedhjen e përfituesit, qytetari (fermeri) është i obliguar t'i sjellë ato në afatin i cili i caktohet, në të kundërtën e humb të drejtën për të qenë përfituesi i subvencionit (grantit).

Data e aplikimit, prej 26.30.2021 deri më 30.04.2021